

AKT THEMELIMI DHE STATUTI

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“European Marketing Experience” SH.P.K

Sot me date 11.07.2022

Z. Klaudio Metaj, atesia Feta , shtetas Shqiptar, lindur me 28.11.1984, ne Vlore, banues ne Tirane, me dokument identifikimi ID I41128035L

&

Znj. Aida Metaj, atesia Feta , shtetase Shqiptare, lindur me 0.6.08.1988, ne Vlore, banuese ne Tirane, me dokument identifikimi ID I85806049T

Bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tone te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kemi hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI.1

DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

Sot ne dat 11.07.2022 u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin :

“European Marketing Experiece” SH.P.K

Themeluesit e shoqerise jane

1. Z. Klaudio Metaj, atesia Fetah, shtetas Shqiptar, lindur me 28.11.1984, ne Vlore, banues ne Tirane, me dokument identifikimi ID 141128035L
2. Znj. Aida Metaj, atesia Fetah, shtetase Shqiptare, lindur me 0.6.08.1988, ne Vlore, banuese ne Tirane, me dokument identifikimi ID 185806049T

NENI. 2

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

Shërbim marketingu, marketing i përgjithshëm, publikim i reklamave online dhe në terren, edhe për palë të treta , bashkëpunim me zyra të të njëjtit profil; bashkëpunim me struktura akomoduese; bashkëpunim me klinika mjeksore të profileve të ndryshme; zhvillim edhe publikim faqeve online për subjekte edhe reklamim online i tyre, dizejnim e zhvillim dhe mirëmbajtje sistemesh software,përmirësim/upgrade sistemesh informatike; shitje e paketave mjeksore, estetike , turistike ne marveshje me subjektet bashkëpunuese, ose për palë të treta, transport mallrash; kultivimin, import, eksport dhe tregtimin e luleve/bimëve dekorative te ndryshme;

Studim, projektim, konsulencë dhe shitje e planeve të biznesit ndaj të shoqerive të ndryshme; promovimi dhe reklamimi, mbledhja e informacionit, kërkimi shkencor ose kërkim tregu, etj.

Montim,cmontim, transport te materialeve dhe stukturave te ndertimit te pergjithshme. Import dhe eksport materialesh dhe instrumentash mjeksore; Ndertim objektesh, rekrutim dhe alokim burimesh njerezore.

Cdo aktivitet tjetër te lidhur me aktivitetin kryesor, dhe jo vetem

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI 3

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar

Shoqeria mund te prishet perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

NENI 4

SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise eshte ne adresen: Tirane, Rr. "Frederik Shiroka", Nr.Pasurie 5/269+3-35, Pallati ALBA, Shk.3, Ap.35.

KREU II

KAPITALI

NENI 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 500.000(peseqind mije) leke i perbere nga 2 kuota.

Pjesemarrja e ortakeve themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte 100.000 leke dhe perbehet nga 2 (dy) kuota me vlere nominale te kuotes 100.00 leke nga Ortaku:

Z. Klaudio Metaj, atesia Fetah, shtetas Shqiptar, lindur me 28.11.1984, ne Vlore, banues ne Tirane, me dokument identifikimi ID I41128035L, zoteron 70% te kuotave te shoqerise.

Znj. Aida Metaj, atesia Fetah, shtetase Shqiptare, lindur me 06.08.1988, ne Vlore, banuese ne Tirane, me dokument identifikimi ID I85806049T; zoteron 30% te kuotave te shoqerise.

Kontributet e ortakeve mund te jene ne para ose ne natyre (pasuri te huajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI. 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.

NENI. 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes

- c) Trashëgimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.

Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashëgimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANET VENDIMMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali

- i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla procedurale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njeitin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te kuotave, jane te

pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 85 te ketij ligji.

Nese kuorumi i percmundur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshine vendos me 1/4 e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shpemdarrjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin per:

- a) vleresimin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13

ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emerion nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte riprteritje. Emerimi i administratoreve prodhon cefekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara:

Z. Klaudio Metaj, atesia Fetah, shtetas Shqiptar, lindur me 28.11.1984, ne Vlore, banues ne Tirane, me dokument identifikimi ID 141128035L;

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine
- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit, dhe jo vetem
- g) Raportoje para Asamblese se Pergjithshme nepermjete relacioneve mbi zbatimin e politikave tregetare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise

h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprime ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.

2. Nese administratori vepron ne kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV

VITI FINANCIAR -EKSPERTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor.

NENI 17

EKSPERTET

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Në përmbushje të kësaj detyre eksperti kontabel i autorizuar për gatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe atë për kontrollet periodike të ushtruara.

KREU 5

PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDMI I SHOQËRISË

Shoqëria konsiderohet e shpërndarë kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqërisë
- b. Me vendimet e asamblese së Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave të falimentit
- d. Nëse nuk zhvillon aktivitet tregtar për 2 vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykatë.

NENI 19

RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblese së Ortakeve, në përputhje me dispozitat ligjore të ligjit mbi shoqëritë tregtare.

NENI 20

KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortakët dhe administratorët e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, nuk mund të mbajnë pozicionin drejtues apo të jenë të punësuar në një shoqëri që ushtron aktivitet në të njëjtën fushë me të parën. Ndalimi i pikës 1 mund të anulohet në asamblenë e parë të përgjithshme me 1/4 e votave në sipas , dispozitave të nenëve 87 dhe 145 të ligjit për shoqëritë tregtare.

NENI 21

LEGJISLACIONI

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 datë 14.04.2008 'Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare'.

NENI 22

MOSMARRREVESHJET

Për mosmarrvëshjet midis ortakëve të shoqërisë, ose shoqërisë me të tretet, gjykata kompetente për zgjidhjen e tyre do të jetë Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua në 4 kopje në gjuhën Shqipe

ORTAKËT THEMELUES

Z. Klaudio Metaj



Znj. Aida Metaj

